



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1703 pot.

Tiranë, më 04.12.2025

V E N D I M

Nr. 289, datë 04.12.2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori në shqyrtim ankesën me nr. 83, datë 3.4.2025, paraqitur nga z. Sh.B (në vijim ankuesi) kundër Bashkisë Patos, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pas shqyrtimit përfundimtar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur përpara Komisionerit, ankuesi parashtron se:

“Unë i nënshkruari Sh.B, banor i qytetit Patos, me profesion jurist, i drejtohem institucionit tuaj, pasi ndihem i diskriminuar për arsyet të cilat do i parashtroj në vijim:

Kam punuar pranë Bashkisë Patos që në vitin 2011 deri në 18.12.2024. Pozicionin si Sekretar i Përgjithshëm e mbajta nga 1 janar 2020 deri më 18.12.2024. Më datë 08.03.2024 me vendim të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është marrë ndaj meje masa e sigurisë ndaluese “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”, si rrjedhojë u pezullova nga funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm, ku sipas legjislacionit të shërbimit civil nuk e humbisja vendin e punës. Më datë 03.05.2024 me vendimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, jam marrë i pandehur dhe më është komunikuar akuza.

Me datë 31.07.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr.479, ka konstatuar shuarjen e masës ndaluese “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”. Me vendimin nr. 172, datë 25.09.2024, Kryetari i Bashkisë ka hequr

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

masën e pezullimit nga puna dhe më ka rikthyer në pozicionin e mëparshëm të Sekretarit të Përgjithshëm.

Nga data 26.09.2024, kur kam rifilluar punë dhe deri në ditën kur më është komunikuar largimi nga shërbimi civil, nuk jam lejuar nga Kryetari i Bashkisë që të ushtrojë funksionet e mia dhe kjo për faktin se kisha statusin e të pandehurit. Duke u ndjerë i diskriminuar për këtë fakt, më datë 19.11.2024, kam bërë ankesë pranë KMD ndaj Bashkisë Patos, për të gjitha veprimet diskriminuese që Kryetari i Bashkisë ka kryer ndaj meje. Komisioneri pas ankesë time i ka dërguar Bashkisë Patos shkresën nr. 1575/1 prot, datë 26.11.2024. me lëndë “Njoftim dhe kërkesë për informacion”.

Menjëherë pas kësaj shkrese, Kryetari i Bashkisë ka ngritur Komisionin Disiplinor dhe me shkresën nr. 4389/1 prot, datë 12.12.2024, më është njoftuar nisja e ecurisë disiplinore ku dhe është caktuar takimi i ballafaqimit ku do të shqyrtohej shkella e pretenduar me Komisionin Disiplinor në datë 13.12.2024, ora 10.00. Me këtë shkresë jam njohur në orën 15.30.

Takimi me Komisionin Disiplinor nuk u realizua me datë 13.12.2024 dhe me shkresën nr.4389/2 prot, datë 13.12.2024, u njoftova se takimi ishte shtyrë për në datë 16.12.2024, ora 10.00. Edhe takimi i datës 16.12.2024, ora 10.00, u shty me një orë tjetër dhe u realizua në orën 11.00. Kjo shtyrje bëhej vetëm me qëllimin që unë të hiqja dorë nga ankesa që kisha bërë pranë KMD (ankesa nr.241, datë 19.11.2024). Pas marrjes së njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore, kërkoja nga Komisioni që të njihesha me dosjen time disiplinore. Nga ana e Komisionit Disiplinor mu vendos në dispozicion dosja disiplinore ku ishin disa shkresa të vitit 2021, 2022 dhe 2023, por nuk më është vendosur në dispozicion materiali hetimor, ku të përcaktoheshin hapat hetimor të kryer nga ana e tij, shkeljet konkrete të kryera nga unë, bazën ligjore ku mbështeteshin pretendimet e tyre dhe pasojat e ardhura nga shkeljet e pretenduara.

Më datë 18.12.2024, jam njoftuar mbi vendimin e Komisionit Disiplinor nr.4389/5, datë 18.12.2024 “Mbi shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit Sh.B”, ku ndaj meje është marrë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, si dhe me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Patos nr.240, datë 18.12.2024 “Për largim nga shërbimi civil”.

Marrja e masës disiplinore ndaj meje si nëpunës civil është kryer nga Komisioni Disiplinor i ngritur në kundërshtim me parashikimet që bën Kreu 1, pika 3, të VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin e Disiplinës në shërbimin civil”. Anëtarët e Komisionit të Disiplinës, C.R, S.M dhe N. H, nuk janë nëpunësit civil më të vjetër të Bashkisë Patos dhe nuk duhet të ishin anëtar të këtij Komisioni. Këta anëtar janë vendosur për të vetmen arsye se i bindeshin urdhrave të Kryetarit të Bashkisë. Nëpunësit civil më të vjetër të bashkisë që duhet të ishin anëtar të Komisionit Disiplinor janë, M. Sh, E.G dhe L. Q.

Komisioni Disiplinor me shkresën nr. 4389/1 prot, datë 12.12.2024 më ka njoftuar nisjen e ecuresë disiplinore, ku dhe është caktuar takimi i ballafaqimit ku do të shqyrtohej shkelja e pretenduar me Komisionin Disiplinor në datë 13.12.2024 ora 10:00, pra të nesërmen e ditës së njoftimit të nisjes së ecuresë disiplinore.

Takimi me Komisionin Disiplinor nuk u realizua më datë 13.12.2024 dhe me shkresën nr. 4389/2 prot, datë 13.12.2024, u njoftua se ky takim ishte shtyrë për në datën 16.12.2024 ora 10:00. Edhe takimi i datës 16.12.2024, ora 10:00 u shty në një orë tjetër dhe u realizua në orën 11.00. Takimi u realizua brenda 4 ditëve nga njoftimi, fakt i cili bie në kundërshtim me Kreun II, pika 13, shkronja “ç” të VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”. Të gjitha këto shtyrje janë bërë si formë presioni ndaj meje dhe vetëm me qëllim, dhe ky qëllim ka qenë heqja dorë nga ankesa që unë kisha bërë kundër Bashkisë Patos, pranë KMD.

Pasi i njoha me nisjen e ecuresë disiplinore kërkova nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore që të njihem me dosjen e hetimit. Me shkresën nr. 4389/3, datë 13.12.2024, mu vendosën në dispozicion vetëm disa shkresa pa më përcaktuar se kush ishin shkeljet e mia konkrete, deklaratat e dëshmitarëve, apo rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga eprori direkt apo nga Komisioni Disiplinor, fakt i cili bie në kundërshtim me Kreun II, pika 15, të VKM nr.115, datë 05.03.2024 dhe me Kodin e Procedurave Administrative, neni 87, pika 2, shkronja “ç” dhe neni 88, pika 2.

Gjatë takimit me Komisionin Disiplinor më datë 16.12.2024, ora 11:00, i kam bërë me dije Komisionit se e gjithë kjo procedurë po bëhej ndaj meje në kushtet e diskriminimit për arsye se unë kisha paraqitur ankesë pranë KMD. Komisioni Disiplinor në zbatim të nenit 82 të K.Pr.A, kishte për detyrë të vërtetonte që nuk kishte arsye diskriminuese. Fakt të cilin Komisioni nuk e bëri.

Nga ana tjetër, megjithëse neni 42, pika 2 e Kushtetutës, neni 6, i KEDNJ, nenet 4, pika 2, neni 87 dhe 88 të K.Pr.A, garantojnë të drejtën e nëpunësit civil ndaj të cilit kërkohet masa disiplinore për t’u njoftuar, për tu informuar, për t’u njohur me aktet, për tu dëgjuar, për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të kundërshtuar, për tu ankuar në rrugë administrative, dhe për t’u drejtuar eventualisht gjykatës, në rastin konkret rezulton se mua nuk më është dhënë mundësia as për t’u njohur me hetimin e kryer ndaj meje, fakt i cili do më jepte mundësi për të paraqitur shpjegimet e mia, duke mos më krijuar mundësinë për të bërë një mbrojtje efektive.

Për sa më sipër, është e qartë se të drejtat e mia janë cenuar pa një proces të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ, nenet 5, 6, 10, 87 dhe 88 të K.Pr.A, dhe Kreut II, pika 15, e VKM nr.115/05.03.2014.

Komisioni disiplinor për sa i përket pikës 1 të vedimit “Korrespondenca e adresuar ndaj tij për ndjekje dhe zbatim nuk është realizuar”, nuk argumenton se për kë shkresë nuk kam realizuar detyrat,

kush ishin detyrat e mia konkrete që duhet të realizoja të cilat nuk i kam realizuar dhe pasojat që kanë ardhur nga mosrealizimi i tyre.

Komisioni Disiplinor për sa i përket pikës 2 të vendimit “Vërtetime i njëjti person”, nuk përmend vërtetime konkrete që janë shqyrtuar dhe nuk i përmend dhe nuk i kundërshton argumentat e mia të dhëna në seancën e ballafaqimit të datës 16.12.2024.

Komisioni Disiplinor në dhënien e kësaj mase disiplinore mbështetet në detyrat që më janë caktuar në vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.25, datë 26.01.2024 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë dhe Njësi Administrative”. Por, si mund të bëhet një hetim administrativ dhe të merret ndaj meje një masë disiplinore duke u mbështetur në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë për vitin 2024, ndërkohë që pretendimet e Komisionit Disiplinor për shklejet që pretendohen që janë kryer para vitit 2024, kohë në të cilën kjo rregullore nuk i shtrin efektet juridike. Pra, Komisioni Disiplinor është mbështetur mbi një akt administrativ që nuk ka efekte juridike për periudhën që mbështeten pretendimet e tyre.

Komisioni Disiplinor për sa i përket pretendimit se “lëshimi i këtyre vërtetimeve janë dhënë pa shlyer taksat dhe tarifat vendore, një kusht ky i ndërmarrë nga institucioni me qëllim arkëtimin e detyrimeve...” nuk ka përcaktuar se në cilën bazë ligjore mbështetet që qytetarët duhet të paguajnë taksat dhe tarifat vendore si kusht për lëshimin e një vërtetimi të tillë, me gjithë këmbënguljen time në seancën dëgjimore të datës 16.12.2024, për të përcaktuar bazën ligjore ku mbështesin pretendimet e tyre.

Në këto kushte, kjo vendimmarrje cenon një prej parimeve themelore të së drejtës “nulla poena, sine lege”, që do të thotë “nuk ka dënim, pa ligj”, parim i sanksionuar edhe në nenin 29 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenin 7 të KEDNJ, që i referohet proceseve penale, por që aplikohet mutatis mutandis edhe në proceset administrative.

Komisioni Disiplinor ka shkelur parimin e proporcionalitetit, ku neni 12 i K.Pr.A-së parashikon se çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale ose mund të cenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës, i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe në përpjestim me të drejtën që e ka diktuar atë.

Ky parim është konfirmuar edhe në nenin 60, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunëin civil”, si parim për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore. Në këtë nen përcaktohet se masat disiplinore të Komisionit Disiplinor duhet të bazohen në shkaqet, rrethanat e kryerjes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj. Në shkallën e fajësisë, ekzistencën e masave të tjera disiplinore të

mëparshme të pashuara. Gjithashtu këto masa disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e tyre. Komisioni Disiplinor në marrjen e vendimit nr.4389/5, datë 18.12.2024, nuk është mbështetur në asnjë nga kriteret e përcaktuara më sipër, çka do të thotë se largimi nga shërbimi civil është i paligjshëm dhe është bërë si formë hakmarrje ndaj meje për shkak të ankimit që kisha bërë pranë KMD.

Diskriminimi ndaj meje ka vazhduar edhe në ndërprerjen e marrëdhënies së punës, pasi në vendimin nr. 240, datë 18.12.2024, duhet të më jepeshin 2 paga shpërblim, kjo bazuar në nenin 1, shkronja “a” dhe nenit 7, të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” si dhe shpërblimi për lejen vjetore të pakryer për vitin 2023 dhe 2022.

Për këtë arsye unë i jam drejtuar Bashkisë Patos për plotësimin e vendimit nr.240, datë 18.12.2024, duke më paguar 2 paga shpërblim dhe lejen vjetore të pakryer për vitin 2023. Bashkia Patos për këtë kërkesë më ka kthyer përgjigje negative në kundërshtim të plotë me ligjin. VKM nr. 568 datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”:

- (i) Kreu III, pika 8, parashikon: “Pushimet vjetore të paguara, përfshirë rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar për arsye të paparashikuara dhe kryerja e pushimeve vjetore është e pamundur. Në këtë rast, i punësuari, të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës, ka të drejtë të përfitojë një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, është e pavlefshme.”*
- (ii) Kreu III, pika 9, parashikon: “Llogaritja e shpërblimit, e përcaktuar në pikën 8, të këtij kreu, bëhet në përpjestim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, në të cilin të punësuarit i ka përfunduar marrëdhënia e punës dhe ai duhet të jepet brenda të njëjtit vit kalendarik. Në rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, shpërblimit të llogaritur në përpjestim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, i shtohet edhe shpërblimi që i takon për pushimet e pakryera dhe të mbartura nga vitet e mëparshme.”*

Pra, nga gjithë cituar më sipër, largimi im nga puna ka ardhur për shkak të ankimit tim të mëparshëm pranë KMD-së, ndaj kam zgjedhur si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër” që lidhet me viktimizimin si një nga format e diskriminimit.”

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit ndaj tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 12/1/c, të LMD përcaktohet: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.588/1prot., datë 18.04.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Patos në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.
2. Me shkresën nr. 1203/1 prot., datë 30.04.2025, Bashkia Patos ka kthyer përgjigje duke parashtruar ndër të tjera:

Pala ankuese Sh.B ka qenë punonjës i Bashkisë Patos dhe me vendimin për ngritje në detyrë në shërbimin civil nr. 1855/11, datë 13.10.2020, është emëruar Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Patos.

Me vendimin nr.19, datë 08.03.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është marrë ndaj tij masa e sigurisë “*Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik*”. Në zbatim të shkresës nr. U67/3 prot (D.M), datë 11.03.2024, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar “*Urdhër për ekzekutim vendimi nr.19, datë 08.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*”, u vendos me shkresën nr.58, datë 12.03.2024 pezullimi i z.B.. Me vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.172, datë 25.09.2024, në zbatim të vendimit nr.422, datë 16.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u konstatua shuarja e masës së sigurimit ndaluese “*Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik*” të z.B. dhe u rikthye në pozicionin që kishte patur para pezullimit si Sekretar i Përgjithshëm i Bashkisë Patos.

Pranë Bashkisë Patos është depozituar shkresa nr.1575/1 prot., datë 26.11.2024 nga KMD, me lëndë “*Njoftim dhe kërkesë për informacion*”, në të cilën pala ankuese ishte shprehur se ndeshëj çdo ditë me një ambient diskriminues në Bashkinë Patos. Të ndodhur para këtij fakti, me urdhër nr.298 datë 03.12.2024 u ngrit grupi i punës për informacion, i cili shqyrtoi kërkesën e ardhur nga Komisioneri dhe ankesën e palës ankuese. Në kushtet kur z. B. ishte shprehur në ankesë drejtuar Komisionerit se ndeshëj çdo ditë me një ambient diskriminues, nga Komisioni i ngritur për t’u marrë me këtë çështje u pyetën të gjithë punonjësit e institucionit mbi marrëdhëniet e punës me Sekretarin e Përgjithshëm, komunikimet me të, kërkesat e tij për raportimin e detyrave etj, për të cilën u mbajt procesverbal me nr.4250/3 prot, datë 10.12.2024, i cili iu dërgua KMD.

Marrë indicie nga deklaratat e punonjësve të cilët janë shprehur se Sekretarin e Përgjithshëm nuk e kanë ndeshur në institucion pas rikthimit të tij në detyrë dhe se nga ana e këtij të fundit nuk janë realizuar takime, nuk është kërkuar asnjë informacion as verbalisht as me *email* ose çdo lloj komunikimi zyrtar, mbi realizimin e detyrave të ngarkuara, pasi një nga detyrat funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm të përcaktuar në Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Patos dhe njësive administrative” është : “*Zhvillon takime të vazhdueshme me drejtuesit e drejtorive dhe institucioneve vartëse për zbatimin e detyrave të kërkuara nga Kryetari i Bashkisë dhe jep mendimin e tij Kryetarit të Bashkisë për nivelin e aftësisë administrative dhe rëndësinë e stafit në administrim dhe kryerjen e detyrave*”, me kërkesë të eprorit direkt filloi ecuria disiplinore me urdhrin nr.308, datë 12.12.2024.

Komisioni Disiplinor shqyrtoi të gjithë praktikat e konstatuara të shkeljeve disiplinore dhe vuri në dijeni nëpunësin Sh.B nëpërmjet shkresës nr. 4389/1 prot., datë 12.12.2024.

Me shkresën nr.4389/3 prot, datë 13.12.2024, i është vënë në dispozicion gjithë dosja e procedimit duke e njoftuar dhe për ditën e ballafaqimit, e cila është shtyrë për shkak të angazhimeve të Komisionit Disiplinor, duke e njoftuar edhe nëpunësin. Ballafaqimi për ecurinë disiplinore u mbajt

me datë 16.12.2024, ora 11:00, e cila u regjistrua në audio dhe më pas u transkriptua në procesverbalin i cili mban nr.4389/4 prot, datë 16.12.2024.

Në përfundim të shqyrtimit të ecurisë disiplinore Komisioni Disiplinor ka marrë vendim nr.4389/5 datë 18.12.2024 për vazhdimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit civil z. B., duke i dhënë masë disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*. Me vendimin nr.240, datë 18.12.2024, iu shkëputën marrëdhëniet e punës me Bashkinë Patos. Për këtë vendim është marrë dijeni nga pala ankuese me datë 18.12.2024.

Pranë Bashkisë Patos është depozituar shkresa me nr.1807 akti, datë 10.03.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, së bashku me kërkesë padinë dhe aktet bashkëlidhur.

Detyrat funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm janë të përcaktuara në vendimin nr. 25, datë 26.01.2024 *“Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Patos dhe njërive vartëse”*, të nënshkruar nga vetë pala ankuese dhe në përshkrimin e pozicionit të punës.

Referuar pretendimit se njoftimi është shtyrë me qëllim që të hiqte dorë nga ankesa drejtuar KMD nuk qëndron, sepse ky proces nuk ka qenë i qëllimshëm, por ka ardhur për vetë faktin e ngarkesës së Kryetarit të Komisionit, si eprori direkt i ankuesit, i cili e ka patur të pamundur prezencën në takimin e planifikuar fillimisht. Në procedurat e mëparshme disiplinore të zhvilluara nga vetë pala ankuese në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm kundrejt punonjësve të vet është ndjekur e njëjta procedurë. Në analogji, sipas pretendimeve të vetë ankuesit, procedura e ndjekur nga ky i fundit ndaj punonjësve të tij do të konsiderohej e qëllimshme.

Në respektim të afateve ligjore, pavarësisht se nga vetë Sekretari i Përgjithshëm nuk është respektuar asnjëherë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të tij si Sekretar i Përgjithshëm dhe nëpunësi më i lartë sipas ligjit, nëpërmjet njoftimeve zyrtare është shtyrë shqyrtimi i shkeljeve të konstatuara në diën e katërt. Theksojmë se nga vetë pala ankuese është kërkuar ky fakt verbalisht në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, pasi me datë 17.12.2024, e cila ishte dhe afati ligjor për takimin, pala ankuese kishte seancë gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe duhet të ishte prezent.

Pretendimi i palës ankuese se nuk është njohur me dosjen e procedimit nuk qëndron për faktin se dosja i është dorëzuar me shkresën nr. 4389/3 prot, datë 13.12.2024. Pretendimi se në përmbajtje të dosjes ishin vetëm shkresa është absurd, pasi dosja përmbante gjithë materialet hetimore, të cilat janë diskutuar edhe në takimin e realizuar më datë 16.12.2024, të regjistruar audio dhe të transkriptuar në procesverbalin nr.4389 prot, duke përfshirë autorizimin e dhënë nga sekretari pa elementët e nevojshëm që duhet të ketë akti, pasi nuk kishte të përcaktuar kujt i drejtohet, gjë të cilën pala ankuese gjatë ballafaqimit është shprehur kundrejt Kryetarit të Komisionit njëkohësisht edhe Kryetar i Bashkisë, se : *“ në kohën kur është lëshuar akti, nuk keni qenë eprori im direkt”*. Ndërkohë, në ligjin për shërbimin civil parashikohet se: *“Procedimi disiplinor fillon pa vonesë, me marrjen dijeni për një shkelje disiplinore, por jo më vonë se brenda një afati 2-vjeçar nga data*

e kryerjes së shkeljes. Në rastin e shkeljeve të rënda, që mund të rezultojnë në marrjen e masës disiplinore të largimit nga shërbimi civil, afati është 8 vjet”.

Dosja hetimore përmbante vërtetime identiteti të dhëna nga Sekretari i Përgjithshëm pa kërkesë të depozituar në institucion pavarësisht formës së saj, fakt ky i cili bie në kundërshtim me nenin 58-63 të K odit të Procedurave Administrative, me udhëzuesin e bashkisë për marrjen e kërkesave dhe rregullave të vendosura nga institucioni për mbledhjen dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore referuar ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për taksat dhe tarifat vendore”* i ndryshuar dhe paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Kjo vendimarrje e palës ankuese është marrë në shkelje të ligjit dhe i ka shkaktuar buxhetit të bashkisë një dëm ekonomik në vlerën 254, 126 lekë, fakt i cili i është vënë në dukje edhe gjatë takimit palës ankuese dhe në dosjen hetimore.

Dosja hetimore përmbante korrespondencën drejtuar palës ankuese për ndjekje dhe zbatim, e cila nuk kishte asnjë material bashkëlidhur për përmbushjen e detyrave të lëna, gjë e cila ka sjellë pengesë në përmbushjen e funksioneve administrative të saj dhe si rezultat performancë jo të mirë në institucion, pasi raporti i performancës është një tregues i rëndësishëm i institucionit.

Referuar detyrave funksionale të miratuara me vendimin nr. 25, datë 26.01.2024 *“Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Patos dhe njësisve vartëse”*, të nënshkruar nga vetë pala ankuese, ku në përshkrimin e pozicionit të punës përcaktohen detyrat e nëpunësve përfshirë dhe palën ankuese, është konstatuar mospërmbushje e detyrave sipas pikave të mëposhtme:

h) Ndjek detyrat e caktuara nga Kryetari i Bashkisë nëpërmjet shënimeve mbi korrespondencën e përditshme në bashki dhe ndihmon drejtoritë ose sektorët në zbatimin në kohë dhe në cilësi të tyre.

j) Zhvillon takime të vazhdueshme me drejtuesit e drejtorive dhe institucioneve vartëse për zbatimin e detyrave të kërkuara nga Kryetari i Bashkisë dhe jep mendimin e tij Kryetarit të Bashkisë për nivelin e aftësive administrative dhe rëndësinë e stafit në administrimin dhe kryerjen e detyrave. Komunikon për probleme organizative të funksionimit të administratës, jep urdhra dhe pret raportime për zgjidhjen e problemeve. Përgatit materiale raportuese, analiza mbi bazën e materialeve të përgatitura nga drejtoritë dhe ia dorëzon Kryetarit të Bashkisë.

th) Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës përpara Kryetarit të Bashkisë për performancën e funksioneve të tij në përmbushjen e detyrave të caktuara.

Detyrat funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm janë të përcaktuara me vendimin nr.25, datë 26.01.2024 *“Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë së Patosit dhe njësisve administrative”*.

Pretendimi i palës ankuese se Komisioni Disiplinor është ngritur në kundërshtim me ligjin sepse nuk ka qenë nëpunësi më i vjetër civil, është në interpretim të gabuar të ligjit, pasi Komisioni Disiplinor i ngritur është përbërë nga: Kryetari i Bashkisë, i cili është eprori direkt i nëpunësit; Drejtori i Burimeve Njerëzore; Përgjegjësjë e Sektorit Juridik, në cilësinë e nëpunëses më të vjetër

civile në fushën e nëpunësit, pra në çështjet juridike; Drejtori i të Ardhurave Vendore në bashki, nëpunës civil i lartë drejtues; Përgjegjëse në Drejtorinë e Projekteve, nëpunëse civile mbi 8 vjet.

Për sa i përket dispozitës ligjore të parashikuar në Kreun I, pikën 3, e cila parashikon se Komisioni Disiplinor përbëhet nga 5 anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme: nëpunësin më të lartë civil në atë institucion; Në këtë rast është drejtori nëpunësi më i lart civil; eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; Kryetari është eprori direkt; drejtuesin e njësisë përgjegjëse në atë institucion; Drejtori i Burimeve Njerëzore; nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore (duke qenë se nëpunësi më i vjetër në institucion është znj. E.G, e cila për shkak se procedura disiplinore është zhvilluar në fundvit ngarkesa e punës në këtë sektor ka qenë shumë e madhe) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore. Nuk ka punonjës të tillë pasi nuk është departament ose sektor pozicioni i nëpunësit.

3. Nëpërmjet *emailit* të datës 19.05.2025, ankuesi ka depozituar prapësimet e tij mbi pretendimet e Bashkisë Patos, duke parashtruar ndër të tjera:

Bashkia Patos pretendon se pas marrjes nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të shkresës nr. 1575/1 prot., datë 26.11.2024, ka nxjerrë urdhërin nr. 298, datë 03.12.2024, duke ngritur komisionin për të shqyrtuar kërkesën e ardhur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky komision nuk ka shqyrtuar asnjë nga pikat që ka kërkuar Komisioneri, si dhe nuk ka pasur si qëllim të verifikojë nëse vërtetë ka pasur diskriminim ndaj meje. Komisioni është ngritur nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe i ka ushtruar funksionet e tij në kundërshtim të plotë me nenin 13, të ligjit nr. 10 221, 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Të gjithë punonjësve i bëhej pyetje nëse unë i kisha kërkuar për të më raportuar apo jo, por komisioni ka harruar faktin që vartësit e mi e kishin detyrim të më raportinin edhe nëse unë nuk ia kërkoja. Ky *pseudo* hetim që është bërë nga ana e Bashkisë Patos nuk ka pasur si qëllim për të zbuluar të vërtetën, por për të gjetur *alibi* për të nisur ecurinë disiplinore ndaj meje si një ndëshkim për ankesën që kisha bërë pranë Komisionerit. Ky fakt duket qartë se nga hetimi që është bërë me punonjësit e bashkisë nuk ka dalë asnjë ankesë nga punonjësit për pretendimet që Komisioni Disiplinor ka përdorur për të më larguar nga shërbimi civil.

Bashkia Patos pretendon se me shkresën nr. 4389/3 prot., datë 13.12.2024, më është vënë në dispozicion dosja e procedimit. Ky fakt nuk është i vërtetë dhe kjo duket qartë nga përmbajtja e shkresës, e cila është: 1. Formulari i Përshkrimit të Pozicionit të Punës; 2. Rregullorja e Brendshme; 3. Praktika e ndjekur për Vërtetimin i njëjti Person; 4. Praktika e ndjekur nga ana juaj. Pra duket qartë që bashkëngjitur kësaj shkrese nuk ka qenë hetimi administrativ i realizuar deri në atë kohë nga ana e Komisionit Disiplinor. Ky fakt bie në kundërshtim me:

a. Nenin 87, pika 2, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Administrative e cila parashikon: “*Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim, apo në një takim me palën, dhe përmban*

këto të dhëna: ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës admin-istrative dhe motivimin përkatës;

- b. Nenin 88, pika 2 të po kësaj kodë, cili parashikon: *“Palët, në ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar, mund të paraqesin komente edhe për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatin e mundshëm të procedurës.”*

Pra në bazë të këtyre neneve, Komisioni Disiplinor kishte për detyrë që të më vinte në dispozicion rezultatet e hetimit. Ky fakt nuk është respektuar nga Komisioni Disiplinor.

Bashkia Patos pretendon se afati kur do të bëhej ballafaqimi është kërkuar prej meje, nuk është i vërtetë dhe i pabazuar në prova. Edhe sikur ky pretendim të qëndronte Bashkia Patos kishte një afat kohor për të bërë ballafaqimin nga dita e 5 e njoftimit, pra nga data 17.12.2024 deri në ditën e 16 të njoftimit, pra deri në datën 23.12.2024. Por Bashkia Patos në kundërshtim me ligjin dhe në kushtet e diskriminimit donte të më hiqte sa më shpejtë nga puna në shënjë hakmarrjeje.

Bashkia Patos pretendon se unë kam lëshuar vërtetime i njëjti person, në kundërshtim me ligjin, pasi personat që kanë përfituar nga shërbimi i bashkisë duhet që më përpara të kishin paguar taksat dhe ky fakt ka shkaktuar dëm ekonomik nga ana ime. Por Bashkia Patos në asnjë moment nuk ka përcaktuar se në cilin ligj, VKM, udhëzim apo çdo akt tjetër nënligjor, përcaktohet se qytetari që të përfitoj një shërbim nga pushteti vendor duhet të ketë paguar taksat. Vërtet bashkia ka përmendur disa ligje dhe akte nënligjore por në asnjë nga ato nuk përcaktohet një fakt i tillë. Edhe në procesverbalin e senacës së ballafaqimit të datës 16.12.2024, në faqen 5 të tij, kur unë pyes Kryetarin e Bashkisë se ku thuhet që qytetari duhet të ketë paguar taksat për të përfituar shërbim nga bashkia, ai përgjigjet se nuk thuhet në asnjë vend, por unë po të pyes për kërkesën.

Bashkia Patos pretendon se unë nuk kam zbatuar detyrat e mia, kjo duke u mbështetur në korrespondencën që më është adresuar mua. Korespondenca që ka qënë objekt hetimi administrativ kishte të bënte me pjesëmarrjen time në trajnime apo seminare, kjo vërtetohet më së miri në sqarimet që unë kam paraqitur pranë Komisionit Disiplinor, si dhe në procesverbalin e datës 16.12.2024. Sipas Komisionit Disiplinor shkelja ime ka konsistuar në faktin që unë si kisha raportuar me shkrim Kryetares së Bashkisë së asaj kohe për çfarë isha trajnuar dhe për çfarë ishte diskutuar në seminarin ku unë kisha marrë pjesë. Raportimi nuk është i detyrueshëm të bëhet me shkrim, ai mund të bëhet edhe në mënyrë verbale, fakt të cilën ja kam sqaruar edhe Komisionit Disiplinor. Komisioni Disiplinor në asnjë moment nuk vërteton pasojat e rënda që kanë ardhur nga mos raportimi me shkrim, por kjo ka shërbyer vetëm si pretekst për të më larguar nga shërbimi civil.

Bashkia Patos për shkeljen e detyrave dhe funksioneve të mia si Sekretar i Përgjithshëm mbështetet në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 25, datë 26.01.2024 *“Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë dhe Njësi Administrative”*, por të gjitha shkeljet që Komisioni Disiplinor mi ka adresuar mua, i përkasin viteve 2021, 2022 dhe 2023, pra përpara se ky vendim të miratohet.

Pretendimi Bashkisë Patos se Komisioni Disiplinor është ngritur konform ligjit nuk qëndrojnë, pasi, pretendimi se Përgjegjësjë e Sektorit Juridik, në cilësinë e nëpunëses më të vjetër civile në fushën e nëpunësit, pra në çështjet juridike, është në kundërshtim me VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, Kreu I, pika 3, në të cilën parashikohet, se: *“Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme: a) nënpunësin më të lartë civil në atë institucion; b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion; ç) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nënpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore; d) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.”*

Pra kjo VKM e përcakton shumë qartë se si krijohet Komisioni Disiplinor, dhe nuk përmënd asnjë nga pikat që përdor Bashkia Patos, siç është Përgjegjësjë e Sektorit Juridik në cilësinë e nëpunëses më të vjetër civile në fushën e nëpunësit, pra në çështjet juridike, apo Drejtori i të Ardhurave Vendore, si nëpunës civil i lartë drejtues, ku në fakt Drejtori i Drejtorisë së të Ardhurave Vendore është nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues. Përsa i përket përgjegjëses në Drejtorinë e Projekteve, nuk është nëpunësja më e vjetër në Bashkinë Patos, pasi nëpunësit më të vjetër civil në Bashkinë Patos janë, Mimoza Shtëmbari, E.G dhe L.Q.

E gjitha procedura është bërë si një hakmarrje për ankimin që kisha bërë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kjo duket më së miri nga procedura e ndjekur për të më hequr nga puna duke filluar nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesës së informacionit që ka bërë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e deri tek procedura e ndjekur nga Komisioni Disiplinor. Po të dëgjohet materiali audio që është mbajtur nga Komisioni Disiplinor në seancën e ballafaqimit të datës 16.12.2024, do të kuptohet më së miri presioni psikologjik që është ushtruar ndaj meje në atë takim. Po ti referohemi procesverablit të ballafaqimit të datës 16.12.2024 të mbajtur nga Komisioni Disiplinor, në faqen 7 dhe 8 të tij, duket qartë hakmarrja ndaj meje kur Kryetari i Bashkisë shprehet se *“ti e ke pranuar vetë me shkrim që ske bërë asnjë detyrë prandaj ne jemi në këtë situat sot”*. Për sa më sipër pretendimet e Bashkisë Patos nuk qëndrojnë dhe janë kryer në kushtet e diskriminimit ndaj meje.

4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: *“8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 588/3 prot., datë 5.6.2025, njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore më datë 1.7.2025.

Seanca dëgjimore e datës 1.7.2025 u zhvillua me pjesëmarrjen e të dy palëve pjesëmarrëse në procedurën administrative: ankuesit, z. B. dhe Bashkisë Patos, përfaqësuar nga znj. N.H, e pajisur me autorizimin nr.1203/3 prot., datë 19.06.2025, lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Patos.

5. Në vijim të seancës dëgjimore të datës 1.7.2025, nëpërmjet *emailit* të datës 7.7.2025, dërguar nga adresa: j.sh@bashkiapatos.gov.al, Bashkia Patos depozitoi prapësime në lidhje me pretendimin e palës ankuese sa i takon mos përfitimit të 2 pagave dëmshpërblim, për largim nga funksioni i Sekretarit të Përgjithshëm, sipas përcaktimeve të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 *“Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*, të ndryshuar, duke parashtruar ndër të tjera se:

Nga ana e Bashkisë Patos është mbajtur korrespondencë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, i cili i është drejtuar bashkisë më shkresë zyrtare nr. 6508 prot., datë 13.03.2025, ku kërkon motivacionin e heqjes nga puna të z. B. dhe nëse janë dhënë dy pagat shpërblim. Nga ana e Bashkisë Patos i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 886/1 prot., datë 03.04.2025 Institutit të Sigurimeve Shoqërore, mbi këtë kërkim. Dispozitat ligjore mbi dy pagat shpërblim për subjektet përfituese të ligjit nuk është e shprehur qartë nëse nëpunësit të cilët largohen nga shërbimi civil me masë disiplinore janë kategori e përfitimit të këtyre dy pagave. Kjo në analogji edhe të Kodit të Punës në të cilin përcaktohet se: *“Punëmarrësi përfiton shpërblim për vjetërsi kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm për shkaqe të arsyeshme”*.

Për sa më lart, pala ankuese nuk është diskriminuar, por duke mos dashur të shkaktohet dëm ekonomik në buxhetin e institucionit, i cili është objekt kontrolli nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Bashkia Patos ka pritur hapat që do të ndiqeshin nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore si institucioni më kompetent për zbatimin e ligjit për pensionin suplementar.

6. Nëpërmjet *emailit* të datës 3.9.2025, ankuesi paraqiti prapësimet e tij në lidhje me informacionin e dërguar nga Bashkia Patos, në vijim të seancës dëgjimore, të cilat janë administruar në doje.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Ankuesi Sh.B, ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Patos në datën 3.8.2011, bazuar në aktin e marrjes në punë me nr.575 prot., datë 1.8.2011, të Kryetarit të Bashkisë Patos. Ankuesit i është konfirmuar statusi i nëpunësit civil në datë 26.2.2014, bazuar në aktin e deklarimit *“Për konfirmimin e statusit të nëpunësit Civil”* me nr.795 prot., datë 19.6.2014.

Me vendimin nr.1855/11 prot, datë 13.10.2020, ankuesi është ngritur në detyrë dhe është emëruar në detyrën Sekretar i Përgjithshëm në Bashkinë Patos.

Me datë 08.03.2024 me vendim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (PPKKO) ndaj ankuesit është marrë masa e sigurisë ndaluese *“Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”*. Në zbatim të vendimit të organit të prokurorisë, me shkresën nr.58, datë 12.3.2024, punëdhënësi/Bashkia Patos ka vendosur pezullimin e ankuesit nga detyra.

Më datë 31.07.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Vendimin nr. 479, ka konstatuar *“Shuarjen e masës ndaluese “Pezullim i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik”, dhe në vijim me Vendimin nr. 172, datë 25.09.2024, Kryetari i Bashkisë Patos ka hequr masën e pezullimit nga puna për ankuesin dhe e ka rikthyer në pozicionin e mëparshëm të Sekretarit të Përgjithshëm.*

Ankuesi pretendon se, pas rikthimit në punë më datë 26.09.2024, nuk është lejuar nga Kryetari i Bashkisë Patos që të ushtrojë funksionet e tij si Sekretar i Përgjithshëm. Duke u ndjerë i diskriminuar, në datën 19.11.2024, ka paraqitur pranë Komisionerit një ankesë (ankesa nr.241, datë 19.11.2024) kundër Bashkisë Patos, me pretendimin se ishte duke u diskriminuar në marrëdhëniet e punës për shkak të *“gjendjes shoqërore”*, duke e paragjykuar atë për shkak të faktit se ai kishte qenë person nën hetim për shpërdorim detyre, pavarësisht se Gjykata kishte disponuar me shuarjen e masës së sigurimit ndalues *“Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”*. Në ankesën e tij ndër të tjera ankuesi pretendoi se, ishte cenuar në pagë, ishte penguar në ushtrimin e funksionit si Sekretar i Përgjithshëm, duke mos u angazhuar me punë, përjashtuar dhe mospërfshirë në ushtrimin e detyrave funksionale të Sekretarit të Përgjithshëm të Bashkisë. Me vendimin nr. 129, datë 21.5.2025, Komisioneri në përfundim të shqyrtimit të ankesës nr.241, datë 19.11.2024, ka vendosur: *“Konstatimin e diskriminimit, në formën e shqetësimit, të subjektit ankues, Sh. B, në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Patos, për shkak të gjendjes shoqërore të tij.”*

Ndërkohë që ankesa për diskriminim e paraqitur nga ankuesi kundër punëdhënësit, ishte në shqyrtim pranë Komisionerit, Bashkia Patos ka filluar ecurinë disiplinore në ngarkim të ankuesit. Konkretisht, nga aktet e administruara, si dhe parashtrimet e Bashkisë Patos rezulton se, në momentin që pranë punëdhënësit është administruar shkresa e Komisionerit nr.1575/1 prot, datë 26.11.2024, me lëndë *“Njoftim dhe kërkesë për informacion”*, nëpërmjet të cilës Bashkia Patos është njoftuar për paraqitjen e ankesës për diskriminim në vendin e punës të bërë nga ankuesi, me urdhrin nr, 298, datë 3.12.2024 *“Për ngritjen e grupit të punës për informacion”*, të Kryetarit të Bashkisë Patos, është ngritur grupi i punës i përbërë nga 5 anëtarë dhe i kryesuar nga Kryetari i Bashkisë. Referuar përmbajtjes së tij, konstatohet se urdhri ka si bazë shkresën nr.1575/1 datë 26.11.2024 të Komisionerit. Në referim të pikës 2, të këtij urdhri, përcaktohet se: *“Dokumentacioni i përgatitur për raportim i drejtuesve të mësipërm t'i dërgohet bashkëlidhur kthim përgjigjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi brenda ditës 04.12.2024.”*

Sipas procesverbalit nr.4250/3 prot, datë 10.12.2024, grupi i punës i krijuar bazuar në urdhrin nr.298, datë 3.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Patos është mbledhur në datën 4.12.2024. Referuar

përbajtjes së këtij procesverballi rezulton se, gjatë këtij takimi janë pyetur punonjësit e Bashkisë Patos në lidhje me sjelljen dhe marrëdhënien që ata kanë patur me ankuesin si Sekretar i Përgjithshëm, ndërsa janë pyetur edhe vetë anëtarët e grupit të punës nga ana e Kryetarit të Bashkisë. Natyra e pyetjeve që iu janë drejtuar punonjësve janë: *A e dini kush është Sekretari i Përgjithshëm; Kur keni folur për herë të fundit; A e keni numrin e telefonit dhe emailin e Sekretarit të Përgjithshëm; Cila ka qenë detyra e fundit që ju ka caktuar; A keni raportuar ndonjëherë tek Sekretari i Përgjithshëm apo ju ka kërkuar raportim; Si ka qenë sjellja e Sekretarit të Përgjithshëm ndaj jush; Jeni ndjerë ndonjëherë i ofenduar nga Sekretari i Përgjithshëm ose je ndjerë ndonjëherë i trajtuar jo në mënyrën e duhur.*

Nga aktet e administruara nuk rezulton që grupi i punës, i krijuar me urdhrin nr.298, datë 3.12.2024, në vijim të takimit të datës 4.12.2024 (procesverballi i këtij takimi është protokolluar me datë 10.12.2024) të ketë konkluduar me ndonjë raport ku të përmbledhen gjetjet e grupit të punës apo të pasqyrohen shkeljet konkrete të konstatuara.

Nuk rezulton gjithashtu që procesverballi nr.4250/3 prot, datë 10.12.2024 t'i jetë dërguar Komisionerit, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.241/2024, për të cilën edhe ishte ngritur Grupi i Punës.

Me urdhrin nr. 308, datë 12.12.2024 “Për Ngritjen e Komisionit Disiplinor për Nëpunësit Civil”, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Komisioni për ndjekjen e ecuresë disiplinore ndaj ankuesit në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm, i përbërë nga 5 anëtarë dhe i kryesuar nga Kryetari i Bashkisë. Anëtarët e këtij Komisioni janë të njëjtë punonjës të cilët kanë qenë pjesë e grupit të punës të krijuar me urdhrin nr.298, datë 3.12.2024, për mbledhjen e informacionit pas njoftimit të ankesës nr.241/2024, nga Komisioneri.

Me shkresën nr.4389/1 prot, datë 12.12.2024 “Njoftim për nisjen e ecuresë disiplinore”, Komisioni Disiplinor ka njoftuar ankuesin si vijon: “.....ndaj jush ka nisur ecuria disiplinore për mospërmblidhjen e detyrave e klasifikuar si sjellje shumë e rëndë...” dhe se shqyrtimi i shkeljes së pretenduar do të bëhet në datë 13.12.2024. Nëpërmjet shkresës nr. 4389/2 prot, datë 13.12.2024, Komisioni Disiplinor ka njoftuar ankuesin për shtyrjen e takimit më datë 16.12.2024.

Me shkresën që mban datën 16.12.2024, ankuesi ka depozituar sqarime me shkrim në lidhje me ecurinë disiplinore në ngarkim të tij, duke pretenduar se pasi është njohur me dosjen e ecuresë disiplinore që i është vendosur në dispozicion, konstaton se në materialet e vëna në dispozicion nuk përcaktohet asnjë shkelje në ngarkim të tij, se cilat janë veprimet konkrete që ka kryer ose që duhet të kishte kryer, cilat janë pasojat e ardhura, ankimet e personave të interesuar për shkeljet që pretendohet se janë kryer prej tij dhe demin që ka shkaktuar. Gjithashtu ankuesi ka parashtruar para Komisionit Disiplinor se, në bazë të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndalohet çdo procedurë administrative ndaj personit që ka paraqitur ankese për diskriminim deri sa të shprehet Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ankuesi ka kërkuar

nga Komisioni Disiplinor që të ndërpresë ecurinë disiplinore pasi ka shkelje disiplinore dhe se procedura është në kushtet e diskriminimit.

Komisioni Disiplinor është mbledhur për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankuesit më datë 16.12.2024, fakt ky që rezulton i provuar në bazë të procesverbalit me nr. 4389/4 prot, datë 16.12.2024.

Me vendimin nr.4389, datë 18.12.2024 *“Për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit Sh.B”*, Komisioni Disiplinor ka vendosur: *“Të vazhdojë ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit civil Sh.B duke i dhënë masë disiplinore “Largim nga shërbimi civil”*.

Me vendimin nr. 240, datë 18.12.2024 *“Për largim nga shërbimi civil”*, të Kryetarit të Bashkisë Patos, është vendosur: *“1. Z. Sh.B, nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm t'i shkëputen marrëdhëniet e punës me institucionin e Bashkisë Patos. 2. Marrëdhëniet financiare do t'i ndërpriten më datën 19.12.2024, t'i jepet në formë shpërblimi 21 (njëzetë e një) ditë pune nga leja vjetore e pakryer për vitin 2024....”*

Pasi ankuesi ka marrë dijeni në lidhje me vendimin për largimin nga shërbimi civil, i është drejtuar punëdhënësit/Bashkia Patos me një kërkesë për plotësimin e këtij vendimi, nëpërmjet të cilës ka kërkuar:

- 2 paga mujore shpërblim, sipas përcaktimeve të nenit 7, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 *“Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*;
- Shpërblim në masën e pagës për 10 ditë punë, për lejen vjetore të pakryer të vitit 2023, bazuar në VKM nr. 568 datë 6.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”*

Me shkresën nr.4389/11 prot, datë 8.1.2025, Bashkia Patos i ka kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me kërkesën për plotësimin e vendimit, duke parashtruar se, ai nuk mund të përfitonte 2 pagat shpërblim, në referim të nenit 10, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 *“Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*, ndërsa për sa i përket shpërblimit për 10 (dhjetë) ditë leje vjetore të pakryer për vitin 2023, nuk mund të përfitohej sepse ankuesit nuk i ishte refuzar kryerja e pushimeve vjetore nga punëdhënësi. Pas shuarjes së masës së pezullimit ankuesi kishte patur të drejtë të kryente pushimet vjetore të vitit 2023.

Në datën 13.1.2025, ankuesi i është drejtuar përsëri Bashkisë Patos duke ripërsëritur të dy kërkimet e tij. Nuk rezulton që Bashkia Patos ti ketë kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me kërkesën e përsëritur të datës 13.1.2025.

Ankuesi ka paraqitur pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier kërkesën për të përfituar pagesën kalimtare në bazë të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 *“Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”*, i ndryshuar.

Në vijim të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 6508, datë 13.3.2025, DRSSH Fier, i është drejtuar Bashkisë Patos me një kërkesë për plotësimin e informacionit duke kërkuar motivacionin e largimit nga puna të ankuesit dhe nëse ai ishte paguar me dy paga mujore sipas funksionit, pas largimit nga puna.

Me një tjetër shkresë, konkretisht shkresa nr. 7356 prot datë 25.3.2025, DRSSH Fier, i është drejtuar Bashkisë Patos duke kërkuar prej saj që në funksion të aplikimit të ankuesit për të përfituar pagesën kalimtare, të vendoste në dispozicion të DRSSH Fier këto dokumenta: Vertetim për periudhën e shërbimit në funksion ose detyrë dhe Vërtetim page referuese.

Me shkresën nr. 886/1 prot, datë 3.4.2025, Bashkia Patos i ka kthyer përgjigje DRSSH Fier, në lidhje me shkresën nr. 6508 prot, datë 20.3.2025, duke informuar se ankuesi ishte liruar nga shërbimi civil me masë disiplinore për mospërbushje të detyrave funksionale klasifikuar si shkelje shumë e rëndë, bazuar në ligjin nr.152/2013, të ndryshuar. Për sa i përket përfitimit të dy pagave mujore, Bashkia Patos informon se nuk i ka paguar pasi sipas saj, ligji nr.8097, datë 21.3.1996, i ndryshuar nuk e ka të shprehur qartë nëse nëpunësit civil të cilët largohen nga shërbimi civil me masë disiplinore janë kategori përfitimi të këtyre dy pagave. Këtë qëndrim Bashkia Patos e mbështet për analogji me Kodin e Punës, i cili përcakton se punëmarrësi e humb të drejtën e shpërblimit për vjetërsi nëse është pushuar me efekt të menjëhershëm për shkaqe të arsyeshme.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi me nr. 83, datë 3.4.2025, kundër Bashkisë Patos, duke pretenduar se, largimi i tij nga puna ka ardhur për shkak të ankesës së mëparshme për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, që ankuesi kishte paraqitur pranë Komisionerit dhe se një sjellje e tillë përbën diskriminim në formën e viktimizimit.

Në përfundim të shqyrtimit të fakteve e rrethanave të cilat rezultuan të provuara gjatë shqyrtimit të ankesës, si dhe pretendimeve të palës ankuese dhe prapësimeve të subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

- *Lidhur me kërkesë padinë e paraqitur nga pala ankuese për largimin nga puna, pranë Gjykatës.*

Nga aktet e administruara rezulton e provuar se, ankuesi ka paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, një kërkesë padi kundër Bashkisë Patos me objekt: *“Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit Disiplinor nr.4389/5 prot datë 18.12.2024 dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr.240, datë 18.12.2024; Rikthimin në të njëjtin vend pune si Sekretar i*

Përgjithshëm të Bashkisë Patos; Pagesën e pagës nga dita e shkëputjes së marrëdhënieve të punës 19.12.2024 dhe deri në rikthimin në punë në të njëjtin pozicion; Pagesën e dy pagave shpërblim, për shkak të largimit nga funksioni si Sekretar i Përgjithshëm; Pagesën e 14 ditëve shpërblim për lejen e pakryer të vitit 2023; Pagesën e 28 ditëve leje të pakryer të vitit 2022.”

LMD, ka parashikuar në nenin 34, pika 1, të tij se, çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente, ndërsa bazuar në pikën 2, të po këtij neni, parashikohet se, paraqitja e ankimit përpara Komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës. Nga ana tjetër, bazuar në nenin 32/1/a të ligjit LMD, Komisioneri ka kompetencë që të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj.

Në nenin 33, pika 7/4, të LMD, parashikohet: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”*

Nga aktet e administruara nuk rezulton që pranë Gjykatës të jenë duke u shqyrtuar pretendime për diskriminim, të cilat janë objekt i ankesës në shqyrtim. Procesi gjyqësor i cili është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje, ka objekt të ndryshëm nga objekti i ankesës objekt shqyrtimi. Pra, ankuesja ka zgjedhur që të mos kërkojë para gjykatës kërkimin për diskriminim, që ka paraqitur për trajtim para Komisionerit në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kërkesë padia që është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnje dhe çështja objekt shqyrtimi pranë Komisionerit nuk kanë mbivendosje, e për rrjedhojë nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ankuesi.

- *Në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të ankuesit, sa i përket largimit nga puna.*

Marrëdhëniet e punës midis ankuesit Sh.B dhe Bashkisë Patos janë rregulluar bazuar në ligjin ligjin Nr. 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”*, të ndryshuar (në vijim ligji nr.152/2013). Ankuesi ka ushtruar detyrën si Sekretar i Përgjithshëm dhe ka gëzuar statusin si nëpunësi më i lartë civil pranë institucionit të Bashkisë Patos.

Për të vlerësuar pretendimet e ankuesit, nëse me veprimet e tij subjekti kundër të cilit ka paraqitur ankesën e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm në lidhje me largimin nga puna, Komisioneri do të vlerësojë veprimet dhe mosveprimet e subjektit në raport me parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësit civil.

- Ligj nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017)

“Neni 57

Përgjegjësia për masat disiplinore

1. Nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve të nëpunësit civil sipas ligjit.

Shkeljet në shërbimin civil ndahen në:

a) shkelje shumë të rënda;

b) shkelje të rënda;

c) shkelje të lehta.

2. Janë shkelje shumë të rënda:

a) mospërbushja e rëndë e detyrave;

b) mosrespektimi i përsëritur i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja shumë të rënda;

c) moszbatimi haptazi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale;

ç) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune ose më shumë, kur mungesa ka sjellë pasoja shumë të rënda në përmbushjen e detyrave të institucionit;

d) përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës.

Neni 58

Llojet e masave disiplinore

Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

a) vërejtje;

b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

ç) largim nga shërbimi civil.

Neni 59

Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore

.....

2. Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor.

..

4. Komisioni disiplinor fillon procedimin:

a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil;

b) me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil;

c) me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore.

...

7. *Procedimi administrativ disiplinor garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të asistohet gjatë procedimit disiplinor nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, një avokat apo një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate.*

Neni 60

Parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore

1. *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, eprori direkt ose komisioni disiplinor bazohet në:*

- a) *shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e ardhura prej saj;*
 - b) *shkallën e fajësisë;*
 - c) *ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashuara, sipas nenit 61 të këtij ligji.*
2. *Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.*
 3. *Për shkeljet shumë të rënda, të parashikuara në pikën 2 të nenit 57 të këtij ligji, jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 58 të këtij ligji.*
 4. *Për shkeljet e rënda të parashikuara në pikën 3 të nenit 57 jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjat “b” ose “c” të nenit 58 të këtij ligji.*
 5. *Për shkeljet e lehta të parashikuara në pikën 4 të nenit 57 jepet masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58 të këtij ligji.*
 6. *Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.*

- *Vendim nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” (ndryshuar me vkm nr. 437, datë 18.7.2018)*

Kreu I

Organet disiplinore

3. *Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:*
 - a) *nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;*
 - b) *eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
 - c) *drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;*
 - ç) *nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
 - d) *nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore*

Kreu II

Procedura disiplinore

1. Me “procedurë disiplinore” do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkeljeje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor.

.....

10. Në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon ecurinë disiplinore. Në rast të kundërt, eprori direkt i kërkon KD-së të fillojë ecurinë disiplinore.

.....

13. Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, organi disiplinor fillon ecurinë disiplinore dhe njofton, me shkrim, nëpunësin përkatës:

- a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;*
- b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;*
- c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;*
- ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi.*

14. Organi disiplinor heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të 3 nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, e, në veçanti, ai kryen veprimet e mëposhtme:

- a) pyet ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet kundërshtuese;*
- b) rishikon dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr etj.; c) shqyrton dosjen e nëpunësit;*
- ç) thërret nëpunësin për t’u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit;*
- d) verifikon praktikat dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;*
- e) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes*

15. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas pikës 14 të kreut II të këtij vendimi, organi disiplinor i vë në dispozicion nëpunësit që po procedohet materialet e mbledhura gjatë këtij hetimi.

Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore ndaj nëpunësit civil parashikohet në nenin 59, të ligjit nr.152/2013. Sipas pikës 1, të nenit të sipërcituar, masa disiplinore e parashikuar në shkronjën “a” të nenit 58, merret nga eprori direkt, i cili është i detyruar të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen me faj të detyrimeve nga nëpunësi civil, ndërsa masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të nenit 58 të këtij ligji, janë në kompetencën e Komisionit Disiplinor.

Rezulton se, shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankuesit, janë kategorizuar në nivelin shumë të rëndë, për sa kohë që është ngritur Komisioni i Disiplinës, për t'i shqyrtuar ato.

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, akti i parë në lidhje me procedurën disiplinore në ngarkim të ankuesit figuron urdhri nr.308, datë 12.12.2024 *“Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për nëpunësin civil”*, të nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë, Komision i cili do të ishte përgjegjës për ndjekjen e ecurisë disiplinore ndaj ankuesit.

Në lidhje me këtë moment të parë të procedurës disiplinore në ngarkim të ankuesit, Komisioneri vlerëson se, kjo vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 59, pika 4 të ligjit nr. 152/2013, sepse është Kryetari i Bashkisë dhe jo Komisioni Disiplinor ai i cili ka vendosur për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj ankuesit. Kryetari i Bashkisë në cilësinë e eprorit direkt, legjitimohet në bazë të kësaj dispozite që të vërë në lëvizje Komisionin e Disiplinës, por është ky i fundit që ka kompetencën për të vendosur nëse duhet ose jo të fillojë procedura disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil. Urdhri nr.308, datë 12.12.2024 i Kryetarit të Bashkisë, nuk është një kërkesë në cilësinë e eprorit direkt të ankuesit, por nëpërmjet këtij urdhëri është urdhëruar dhe është vendosur fillimi i ecurisë disiplinore ndaj ankuesit dhe kjo vendimarrje nuk është bërë nga Komisioni Disiplinor, por nga Kryetari i Bashkisë që është edhe në cilësinë e eprorit të ankuesit.

Përpara fillimit të procedurës disiplinore nuk ka asnjë akt ku të pasqyrohen se cilat janë konkretisht shkeljet e pretenduara se janë kryer nga ankuesi, të cilat janë vlerësuar se se hyjnë në kompetencën e Komisionit Disiplinor. Në momentin që Komisioni Disiplinor ka filluar procedurën disiplinore në ngarkim të ankuesit nuk rezulton që të jetë përcaktuar se cila apo cilat janë shkeljet për të cilat ky komision është vënë në lëvizje.

Rezulton se edhe përbërja e Komisionit Disiplinor vjen në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3, të kreut I, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, pasi Bashkia nuk arriti të provojë se Komisioni Disiplinor, plotësonte kërkesat e gërmave a, ç dhe d, të pikës 3, të kreut I, të VKM-së, në lidhje me anëtarët Ç.R, S.M dhe N.H, pasi nuk rezultoi e provuar që të jenë nëpunësit civil më të vjetër të Bashkisë Patos. Komisioneri e vlerëson të pabazuar pretendimin e Bashkisë Patos, se nëpunësi më i vjetër në institucion znj. E.G, nuk mund të ishte pjesë e Komisionit Disiplinor për shkak të ngarkesës që sektori ku ajo punon ka në fund të vitit, që korrespondon me periudhën e zhvillimit të procedurës disiplinore.

Në njoftimin që Komisioni Disiplinor i ka bërë ankuesit për nisjen e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij nëpërmjet shkresës nr.4389/1 datë 12.12.2024, nuk rezulton që ti jetë komunikuar atij se cilat janë shkeljet konkrete, të cilat janë vlerësuar si mospërmbushje e rëndë e detyrave dhe është klasifikuar si shkelje shumë e rëndë. Kjo vjen në kundërshtim me pikën 7, të nenit 59, të ligjit nr.152/2013 dhe gërmën “a”, të pikës 13, të kreut II, të VKM nr. 115/5.3.2014.

Njoftimi fillestar për zhvillimin e takimit në datën 13.12.2024, vjen në kundërshtim me kërkesat e gërmës “c”, të pikës 13, të kreut II, të VKM nr.115/5/3/2014, e cila përcakton se data për zhvillimin e takimit nuk mund të caktohet më shpejt se 4 ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi. Në vijim

me shkresën nr. 4389/2 datë 13.12.2024, Komisioni Disiplinor ka njoftuar ankuesin për shtyrjen e datës së takimit më 16.12.2024, kur edhe ky takim është zhvilluar.

Gjatë procedurës disiplinore ankuesit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë akt ku të paqyrohen shkeljet konkrete të cilat pretendohen se janë kryer nga ana e tij. Ankuesit i janë vendosur në dispozicion para zhvillimit të takimit të datës 16.12.2024, sikurse rezulton nga shkresa nr. 4389/3 prot., datë 13.12.2024, të Bashkisë Patos këto akte: Formulari i përshkrimit të pozicionit të punës; Rregullorja e brendshme; Praktikë e ndjekur për “Vertetimin i Njëjti Person”; Korrespondenca e adresuar për ndjekje nga ana juaj. Ankuesit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë akt ku të paqyrohen shkeljet e pretenduara.

Ankuesit nuk rezulton që t’i jetë vendosur në dispozicion edhe procesverbali i datës 10.12.2024, i mbajtur nga grupi i punës, i ngritur për të verifikuar shkresën nr. 1575/1 prot., datë 26.11.2024, të Komisionerit, nëpërmjet të cilës Bashkia Patos është njoftuar për paraqitjen e ankesës për diskriminim nga ana e ankuesit.

Shkeljet e pretenduara nga punëdhënësi/Bashkia Patos se janë konsumuar nga ankuesi mbi bazën e të cilave është bazuar edhe vendimi i Komisionit Disiplinor për largimin nga puna të ankuesit, pasqyrohen vetëm në Vendimin “Për shqyrtimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit Sh.B” Nr. 4389/5 prot, datë 18.12.2024, të Komisionit të Disiplinës, nëpërmjet të cilit është dhënë masa disiplinore ndaj ankuesit “Largim nga shërbimi civil”. Referuar këtij vendimi konstatohet se, shkeljet në ngarkim të ankuesit janë:

- Korrespondenca e adresuar ndaj tij për ndjekje dhe zbatim nuk është realizuar.

Në vendimin e Komisionit Disiplinor nuk ka asnjë arsyetim se cilat janë këto korrespondenca të cilat nuk janë realizuar nga ankuesi dhe cilat janë veprimet apo mosveprimet të cilat janë konsumuar nga ankuesi në lidhje me këto praktika.

Gjatë shqyrtimit të ankesës në lidhje me këtë shkelje Bashkia Patos depozitoi në cilësinë e provës disa prkatika që i përkasin viteve 2021, 2022 dhe 2023. Në lidhje me këto praktika Bashkia Patos nuk ofroi asnjë shpjegim se cilat ishin shkeljet konkrete të ankuesit në lidhje me këto praktika. Pra cilat ishin detyrat e perealizuara dhe cilat ishin pasojat e mosrealizimit të tyre.

Komisioneri konstaton se është e paqartë se si punëdhënësi/Bashkia Patos i ka identifikuar këto praktika, që i përkasin këtyre viteve, kur nga aktet e administruara nuk ka asnjë indicie ose problematikë të konstatuar të lidhur me keto problematika.

- “Vertetime i njëjti person” u janë dhënë qytetarëve pa kërkesë zyrtare, kjo në kundërshtim të Kodit të Procedurës Administrative, pasi pranë bashkisë sonë funksionon shërbimi me një ndalesë, i cili ka si detyrë pranimin e kërkesës për nxjerrjen e një akti administrative nga organi

publik. Këto vërtetime janë dhënë pa shlyer taksat dhe tarifat vendore, një kusht ky i ndërmarrë nga institucioni me qëllim arkëtimin e detyrimeve vjetore të përcaktuara në Paketën Fiskale, të miratuar në Këshillin Bashkiak. Kjo vendimarrje nga Sekretari i Përgjithshëm i ka shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën 254, 126 lekë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Patos depozitoi në cilësinë e provës 32 vërtetime, të lëshuara gjatë viteve 2022, 2023. Pjesa më e madhe e këtyre vërtetimeve janë “*vërtetime i njëjti person*” dhe një pjesë tjetër janë “*vërtetime vendbanimi*”, “*vërtetime për ndryshim emri*” dhe “*vërtetime mbi gjendjen social ekonomike*” të qytetarëve të ndryshëm të Bashkisë Patos.

Komisioneri e gjen të pabazuar pretendimin e Bashkisë Patos se, këto vërtetime janë lëshuar në kundërshtim me Kodin e Procedurave Administrative, sepse nuk ka një kërkesë me shkrim për lëshimin e këtyre vërtetimeve nga ana e qytetarëve.

Neni 58 “*Forma dhe përmbajtja e kërkesës*”, e K.Pr.Adm, parashikon: “*1. Përveçse kur ligji parashikon një formë të caktuar, çdo kërkesë, me të cilën personat i drejtohen organit në një procedurë administrative, mund të jetë: a) në formë të shkruar; b) të deklarohet verbalisht para organit publik dhe të regjistrohet nga ky i fundit; ose c) të bëhet në çdo formë tjetër të përshtatshme.*” Ky rregullim, vjen në harmoni me parimin e deburokratizimit dhe efijencës, parashikuar nga neni 18, i Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet: “*1. Procedura administrative nuk i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji. 2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.*”

Në lidhje me pretendimin tjetër se, këto vërtetime janë dhënë pa shlyer taksat dhe tarifat vendore, një kusht ky i ndërmarrë nga Bashkia Patos me qëllim arkëtimin e detyrimeve vjetore të përcaktuara në Paketën Fiskale, të miratuar në Këshillin Bashkiak, nuk gjen asnjë mbështetje në kuadrin ligjor dhe nënligjon në fuqi, që të kushtëzojë lëshimin e këty lloj shërbimesh me detyrimin që të jenë shlyer taksat dhe tarifat vendore.

Komisioneri vlerëson se ky pretendim i Bashkisë Patos, është jo vetëm i pambështetur në ligj, por është edhe abuziv dhe privon vecanërisht kategoritë vulnerabël nga marrja e shërbimeve të nevojshme. Nga vërtetimet e vendosura në dispozicion nga Bashkia Patos, konstatohet se në disa raste vërtetimet janë lëshuar për të vërtetuar gjendjen social-ekonomike të disa qytetarëve. Konkretisht sipas vërtetimit nr.2122 prot, datë 3.9.2022, vërtetohet se qytetari A.Q është në gjendje të keqe ekonomike dhe ndihmohet financiarisht nga vajza e tij E.P, sipas vërtetimit nr. 1738 prot., datë 14.7.2022, vërtetohet se qytetarja H.P, jeton në shtëpi vetëm me bashkëshortin, sipas vërtetimit nr.1738 prot., datë 14.7.2022, vërtetohet se qytetari K.P jeton në shtëpi vetëm me bashkëshorten.

Referuar akteve të depozituara nga Bashkia Patos, rezulton se dëmi ekonomik në vlerën 254, 126 lekë është shuma e taksave dhe tatimeve vendore që qytetarët nuk kanë paguar. Komisioneri e gjen të pabazuar pretendimin e Bashkisë Patos se, lëshimi i këtyre vërtetimeve nga ana e ankuesit në ushtrim të funksionit si Sekretari i Përgjithshëm i ka shkaktuar buxhetit të bashkisë dëm ekonomik në vlerën 254, 126 lekë, sepse nuk rezulton që ai të ketë kryer veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin nëpërmjet lëshimit të vërtetimeve.

- Nga Sekretari i Përgjithshëm është firmosur një autorizim, i cili nuk përmban elementët formalë të tij, nuk ka të përcaktuar bazën ligjore, gjeneralitetet dhe numrin e identifikimit të punonjësit, duke abuzuar me komtencat e deleguara mbi nënshkrimin e autorizimeve.

Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, në lidhje me këtë shkelje Bashkia Patos ka depozituar autorizimin me nr.918 prot, të vitit 2023, i cili rezulton të jetë nënshkruar nga ish Kryetarja e Bashkisë znj. R. B, nëpërmjet të cilit autorizohet autorizohet nëpunësi, emri i të cilit nuk është vendosur në kopjen që është depozituar, i Bashkisë Patos që të tërheqë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), Tiranë bojë për printer.

Në radhë të parë konstatohet se autorizimi nuk rezulton të jetë nënshkruar nga ankuesi në cilësinë e tij si Sekretar i Përgjithshëm por nga ish Kryetarja e Bashkisë Patos. Së dyti, Bashkia Patos, përveç pretendimit se në autorizim nuk është vendosur emri i nëpunësit, nuk jep asnjë shpjegim se çfarë pasojash kanë ardhur apo të ketë hetuar nëse kopja e autorizimit e cila është depozituar pranë DPGJC në Tiranë ka patur të vendosur edhe emrin e nëpunësit që ka bërë tërheqjen e bojës së printerit apo nëse ky autorizim nuk është përdorur.

- Mospërmbyllja e detyrave të parashikuara në Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr.25, datë 26.1.2024 *“Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së Bashkisë Patos dhe Njësi Administrative”*, sipas pikave të mëposhtme:

h) Ndjek detyrat e caktuara nga Kryetari i Bashkisë nëpërmjet shënimeve mbi korespondencën e përditshme në bashki dhe ndihmon drejtoritë ose sektorët në zbatimin në kohë dhe me cilësi të tyre;

j) Zhvillon takime të vazhdueshme me drejtuesit e drejtorive dhe institucioneve vartëse për zbatimin e detyrave të kërkuara nga Kryetari i Bashkisë dhe i jep mendimin e tij Kryetarit të Bashkisë për nivelin e aftësive administrative dhe rëndësisë e stafit në administrimin dhe kryerjen e detyrave;

Komunikon për probleme organizative të funksionimit të administratës, jep urdhëra dhe pret raportime për zgjidhjen e problemeve;

Përgatit materiale raportuese, analiza mbi bazën e materialeve të përgatitura nga drejtoritë dhe ia dorëzon Kryetarit të Bashkisë;

th) Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës përpara Kryetarit të Bashkisë për performancën e funksioneve të saj, në përmbushjen e detyrave të caktuara”.

Në vendimin e tij Komisioni Disiplinor shprehet se mosrealizimi i detyrave të mësipërme ka sjellë pengesa në përmbushjen e funksioneve administrative të institucionit. Megjithatë në vendimin e Komisionit Disiplinor, aktet e administruara gjatë procedurës disiplinore por edhe gjatë shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit, Bashkia Patos nuk arriti të tregojë se cilat ishin detyrat konkrete të caktuara nga Kryetari i Bashkisë të cilat nuk ishin zbatuar nga ankuesi në funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm apo që ankuesi të kishte vlerësime negative në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij.

Në ankesën nr. 241 datë 19.11.2024, një nga pretendimet e ankuesit ishte se pas heqjes së masës së pezullimit nga detyra dhe rikthimit në detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, datë 26.9.2024, ai ishte mënjeluar dhe penguar në ushtrimin e funksionit të tij. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, me vendimin nr. 129, datë 21.5.2025, Komisioneri ka konsultuar se, shkresat që i adresoheshin ankuesit përpara periudhës së pezullimit janë disa dhjetëra, në ndryshim me situatën pas datës 26.09.2024, ku dukshëm ai ishte shmangur nga përcjellja e shkresave, detyrave apo vënia në dijeni për veprimtarinë e strukturave në varësi të këtij të fundit. Komisioneri ka vlerësuar se, veprimet e punëdhënësit kanë cenuar në thelb dhe pamundësuar ushtrimin e detyrës shtetërore nga ankuesi.

Komisioneri e gjen të pabazuar cilësimin e Komisionit Disiplinor si thyerje të Kodit të Etikës pretendimin e ankuesit se Komisioni i Disiplinës ishte duke vepruar në kundërshtim me ligjin, pasi ai kishte paraqitur një ankesë për diskriminim pranë Komisionerit dhe në këto kushte punëdhënësi nuk duhet vijonte me procedurën disiplinore apo pretendimi se ankuesi do ti drejtohej organeve penale në lidhje me veprimet e punëdhënësit të cilat i konsideronte si në kundërshtim me ligjin. Nga shqyrtimi i procesverbalit të mbajtur gjatë takimit të datës 16.12.2024, Komisioneri nuk konstaton që ankuesi përveç pretendimeve të mësipërme për veprime të pretenduara në kundërshtim me ligjin nga ana e punëdhënësit, të ketë përdorur fjalor fyes.

Sa më sipër Komisioneri arrin në përfundimin se, shkeljet e pretenduara nga Bashkia Patos se janë konsumuar nga ankuesi, në funksionin si Sekretar i Përgjithshëm, nuk rezultuan të provuara. Në këto kushte Komisioneri vlerëson se, ankuesi nuk është në kushtet e mospërmbushjes së rëndë të detyrave, parashikuar nga neni 57, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 152/2013 dhe se marrja e masës disiplinore “*largim nag shërbimi civil*”, sipas përcaktimit të nenit 58, shkronja “ç”, të ligjit të sipërcituar, marrë ndaj ankuesit me vendimin nr.4389/5, datë 18.12.2024, të Komisionit Disiplinor, e vendos ankuesin në kushte të padrejta dhe të disfavorshme.

Rezultoi e provuar se pas marrjes dijeni për shkresën nr.1575/1 prot, datë 26.11.2024 nga Komisioneri, Bashkia Patos, ka filluar procedurën disiplinore ndaj ankuesit më datë 12.12.2024 dhe me vendimin e datës 18.12.2024, të Komisionit Disiplinor ankuesi është larguar nga puna, duke ndërprerë marrëdhënien e punës në shërbimin civil, nëpërmjet marrjes ndaj tij të masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”.

Ndërsa ankuesi pretendonte në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit se ishte duke u diskriminuar nga punëdhënësi dhe jo nga punonjës të tjerë, Bashkia Patos pas marrjes dijeni për paraqitjen e aneksës, nuk ndërmori asnjë masë për të verifikuar pretendimet e ankuesit. Me urdhrin nr.298 datë 03.12.2024, u krijua grupi i punës, i cili edhe pse u ngrit për të verifikuar pretendimet për diskriminim në ambientin e punës të ngritur nga ankuesi pranë Komisionerit, pra ku ankuesi pretendonte se ishte viktimë, referuar procesverbalit të datës 10.12.2024, ka pyetur punonjësit e institucionit nëse sjellja e ankuesit ndaj tyre ishte ose jo korrekte dhe jo anasjelltas.

Komisioneri konstaton se, Bashkia Patos ka vepruar në kundërshtim me nenin 15, pika 2, të LMD, ku përcaktohet se: “2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.”, pasi gjatë shqyrtimit të ankesës për diskriminim punëmarrësi bazuar në këtë dispozitë ligjore ka të drejtën të vazhdojë punën deri në përfundim të shqyrtimit të ankesës nga Komisioneri.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankuesi Sh.B, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm gjatë procedurës disiplinore në përfundim të së cilës ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”.

- Në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të ankuesit, sa i përket refuzimit për të përfutur 2 paga shpërblim, në referim të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”.

Në vijim të vendimit të datës 18.12.2024, të Komisionit Disiplinor për marrjen ndaj tij të masës disiplinore “largim nga shërbimi civil”, me vendimin nr. 240, datë 18.12.2024 “Për largim nga shërbimi civil”, të Kryetarit të Bashkisë Patos ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare më datën 19.12.2024 dhe i janë dhënë në formë shpërblimi 21 (njëzetë e një) ditë pune nga leja vjetore e pakryer për vitin 2024.

Ankuesi i është drejtuar Bashkisë Patos duke kërkuar plotësimin e vendimit nr. nr. 240, datë 18.12.2024, duke i dhënë 2 paga shpërblim, në referim të nenit 10, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” dhe shpërblimit për 10 (dhjetë) ditë leje vjetore të pakryer për vitin 2023, kërtime të cilat u refuzuan nga Bashkia Patos.

- Ligji nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar, përcakton :

Neni 1

Përkufizime

4. Me termin "Përfitime shtetërore suplementare" do të kuptohen përfitimet që jepen sipas këtij ligji

9. Ne termin "Grupi i dyte" do te përfshihen:

a) Sekretaret e Shtetit, zëvendësministrat, zëvendësprokuroret e Përgjithshëm, si dhe personat e tjerë te barazuar me ta, sekretaret e përgjithshëm dhe funksionarët politike pranë Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrave, institucioneve qendrore buxhetore, prefekturave, këshillave të rretheve, këshillave të qarqeve, bashkive dhe personave të tjerë te barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror"

11. Me termin "pagesë kalimtare" kuptohet pagesa që përfitojnë personat, subjekt i këtij ligji, pas ndërprerjes së funksionit ose kur punësohen në një funksion me pagë më të ulët se paga pararendëse.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të jepen përfitime shtetërore suplementare si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror për personat e grupit të parë dhe të dytë.

Neni 3

Personat e mbrojtur

Përfitojnë nga ky ligj personat që përcaktohen në nenin 1.

Neni 4

Financimi

Përfitimet shtetërore suplementare që jepen sipas këtij ligji financohen:

a) nga buxheti i shtetit;

b) nga kontributi që derdhin personat e punësuar.

Neni 7

Personave të grupit të dyte, që përmenden në shtrojën "a" të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese bruto, për atë kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 548, datë 27.7.2016 "Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, përcakton:

14. "Pagesa pas ndërprerjes së funksionit të fundit" bëhet çdo muaj, nga punëdhënësi i fundit, për atë muaj sa përcaktohet në nenin 7, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar.

15. *“Pagesa kalimtare” dhe “pensionet shtetërore suplementare” të të gjitha llojeve caktohen, administrohen dhe paguhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.*

Ankuesi ka mbajtur funksionin e Sekretarit të Përgjithshëm në Bashkinë Patos dhe rrjedhimisht përfshihet në grupin e dytë të personave, parashikuar nga shkronjën “a”, pika 9, e nenit 1, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, të cilët përfitojnë në bazë të këtij ligji.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar, personave të grupit të dytë, që përmenden në shkronjën "a" të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore te funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind te pagës referuese bruto, për aq kohe sa kane punuar ne funksione te tilla, por jo me shume se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

Bazuar në VKM nr. 548, datë 27.7.2016, të ndryshuar, pika 14, dy pagat mujore mujore pas ndërprerjes së funksionit, paguhen nga punëdhënësi i fundit, që në rastin e ankuesit është Bashkia Patos. Në bazë të pikës 15, të VKM së sipërcituar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore është përgjegjës për pagesën kalimtare dhe pensionet shtetërore suplementare.

Ligji nr.8097, datë 21.3.1996, i ndryshuar dhe VKM nr. 548, datë 27.7.2016, i ndryshuar, përcaktojnë qartë se dy pagat mujore i jepen personave përfitues, pas largimit nga funksioni. As ligji dhe as VKM nuk përcaktojnë mënyrën e largimit, por detyrimi që duhet të përmbushet për të marrë këtë përfitim është largimi nga funksioni.

Komisioneri e gjen të pabazuar pretendimin e Bashkisë Patos në lidhje me refuzimin për t’i paguar ankuesit 2 pagat mujore pas përfundimit të funksionit dhe largimit të tij si Sekretar i Përgjithshëm, sepse as ligji nr.8097, datë 21.3.1996, i ndryshuar dhe as VKM nr. 548, datë 27.7.2016, i ndryshuar, të cilat janë aktet që rregullojnë këtë të drejtë, nuk përmbajnë ndonjë ndalim që lidhet me mënyrën e largimit nga funksioni.

Komisioneri gjithahstu vlerëson se, analogjia që Bashkia Patos bën duke referuar tek dispozitat e Kodit të Punës, është e pabazuar, kjo jo vetëm për faktin se marrëdhënia e punës së ankuesit nuk rregullohet nga Kodi i Punës por nga ligji nr.152/2013, i ndryshuar, por edhe sepse këto dy përfitime nuk janë të njëjta ose të ngjashme, pra përfitimi i vjetërsisë në punë në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës dhe përfitimi i 2 pagave mujore pas ndërprerjes së funksionit.

Pagesa e dy pagave shpërblim, por edhe përfitimet e tjera të parashikuara nga ligji nr. 8097, datë 21.3.1996, janë përfitime që jepen për shkak të kontributit që personat përfitues bëjnë në pagesën e sigurimit suplementar, si një shtesë mbi sigurimin e zakonshëm.

Komisioneri gjen të pabazuar jo vetëm arsyen e paraqitur nga Bashkia Patos për mospagesën e dy pagave mujore pas largimit nga funksioni si Sekretar i Përgjithshëm të ankuesit, por edhe pretendimin se ajo ka pritur hapat që do të ndiqeshin nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në VKM nr. 548, datë 27.7.2016, i ndryshuar, përcaktohet qartësisht se Bashkia Patos në cilësinë e punëdhënësit është përgjegjës për të bërë pagesën e dy pagave mujore, ndërsa ISSH, është përgjegjës për përfitimet e tjera, sikurse është pagesa kalimtare dhe pensioni suplementar. Detyrimi i Bashkisë Patos në cilësinë e punëdhënësit është i qartë dhe nuk kushtëzohet nga procedurat që ndiqen nga ISSH.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme, nga ana e Bashkisë Patos, në lidhje me mos pagesën e dy pagave mujore, pas largimit nga funksioni si Sekretar i Përgjithshëm.

- Në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të ankuesit, sa i përket refuzimit për të përfituar shpërblimit për 10 (dhjetë) ditë leje vjetore të pakryer për vitin 2023.

Ankuesi i është drejtuar Bashkisë Patos duke kërkuar plotësimin e vendimit nr. nr. 240, datë 18.12.2024, duke i paguar një shpërblim për 10 (dhjetë) ditë leje vjetore të pakryer për vitin 2023.

Me shkresën nr. 4389/11 prot., datë 8.1.2025, Bashkia Patos, duke mos e kundërshtuar faktin se ankuesi nuk i ka kryer këto 10 ditë nga leja vjetore e paguar për vitin 2023, refuzon që ti paguajë ankuesit këtë shpërblim, me argumentin se, bazuar në pikën 4, të kreut III të VKM nr. 568, datë 6.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ankuesit nuk i është refuzuar kryerja e pushimeve vjetore nga punëdhënësi. Fakti që ndaj ankuesit është bërë pezullim nga Gjykata, nuk do të thotë që është refuzuar nga punëdhënësi dhe se pas shuarjes së pezullimit ankuesi ka patur të drejtën të kryejë pushimet vjetore të vitit 2023.

Komisioneri e gjen të pabazuar këtë pretendim të Bashkisë Patos për të mos i paguar ankuesit shpërblimin në masën e 10 ditë pagë nga leja vjetore e paguar e pakryer për vitin 2023, bazuar në arsyetimin e mëposhtëm.

Sipas VKM Nr. 568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, përcaktohet se:

“III. Pushimet

4. Pushimi vjetor i paguar duhet të jepet gjatë vitit kalendarik ose deri në fund të tremujorit të parë të vitit kalendarik pasardhës. Në rastet kur punëdhënësi nuk miraton kryerjen e pushimeve vjetore apo i punësuari nuk i merr pushimet vjetore, të plota apo të pjesshme, ai ka të drejtë t'i

kryejë ato brenda tre vjetëve nga dita në të cilën i lind kjo e drejtë, duke zbatuar të njëjtën procedurë të parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu.

8. Pushimet vjetore të paguara, përfshirë rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, nuk zëvendësohen me pagesë, me përjashtim të rasteve kur marrëdhënia e punës ka përfunduar për arsye të paparashikuara dhe kryerja e pushimeve vjetore është e pamundur. Në këtë rast, i punësuarit, të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës, ka të drejtë të përfitojë një shpërblim të barabartë me pagën e këtyre pushimeve. Çdo marrëveshje që parashikon heqjen dorë nga e drejta për pushim vjetor, kundrejt pagesës, është e pavlefshme..

9. Llogaritja e shpërblimit, e përcaktuar në pikën 8, të këtij kreu, bëhet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, në të cilin të punësuarit i ka përfunduar marrëdhënia e punës dhe ai duhet të jepet brenda të njëjtit vit kalendarik. Në rastin e parashikuar në pikën 4, të këtij kreu, shpërblimit të llogaritur në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, i shtohet edhe shpërblimi që i takon për pushimet e pakryera dhe të mbartura nga vitet e mëparshme.”

Pika 4, e kreut III, të VKM Nr. 568, datë 06.10.2021, përcakton qartë se, punëmarrësi mund të kryejë lejen vjetore brenda 3 viteve, jo vetëm kur nuk miratohet nga punëdhënësi, por edhe kur ai nuk e ka marrë brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës.

Zëvendësimi me pagesë i pushimeve vjetore të paguara të pakryera nga punëmarrësi, lejohet sipas pikës 8, të kreut III, të VKM nr.568, datë 6.10.2021, në rastet kur marrëdhënia e punës ka përfunduar për arsye të paparashikuara dhe kryerja e pushimeve është e pamundur. Në këtë rast, ankuesit të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës, dhe e drejta për për kryer lejen vjetore të vitit 2023 nuk është shuar, pasi nuk kanë kaluar tre vite, nga dita që i ka lindur kjo e drejtë, ka patur të drejtën që në momentin e zgjidhjes së marrëdhënieve financiare nga Bashkia Patos, pushimet vjetore të paguara të pakryera për vitin 2023, në masën 10 ditë, ti zëvendësoheshin me pagesë. Pika 9, e kreut III, të VKM së sipërcituar, përcakton qartësisht se shpërblimit të llogaritur në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e punës brenda vitit kalendarik, shpërblim i cili për vitin 2024, ankuesit i është dhënë me vendimin nr.240, datë 18.12.2024, duhet ti shtohet edhe shpërblimi që i takon për pushimet e pakryera dhe të mbartura nga vitet e mëparshme, qënë rastin konkret, ankuesit nuk i janë paguar në formë shpërblimi 10 ditë pushime të paguara të pakryera nga viti 2023, në kundërshtim me rregullimet e mësipërme që përcaktohen sipas VKM nr.568, datë 6.10.2021.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të disfavorshme, nga ana e Bashkisë Patos, në lidhje me mospagesën e shpërblimit për 10 (dhjetë) ditë leje vjetore të paguar pakryer dhe të mbartur nga viti 2023.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet

edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Gjykata Kushtetuese³, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfutur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë*”.

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune ndërmjet shtetit dhe një individi/nëpunësit civil, që përfshihet në shërbimin civil dhe rregullohet nga ligji nr.152/2013. Referuar nenit 5, të ligjit nr.152/2023, parimi i mosdiskriminimit, është një nga parimet që udhëheq administrimin e shërbimit civil.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, “*E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*”. Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar mbrojtje në mënyrë të shprehur në lidhje me gjendjen shoqërore Ndërkohë Protokolli 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “*a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi*

³ Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejtë parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”⁴, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim, bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”⁵, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi dhe bazuar në një listë të hapur shkaqesh.

Karta Sociale Europiane⁶ në nenin 1, pika 2, parashikon: “Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim⁷. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet mbrojtja nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh, të cilët janë të njëjtë me ata të parashikuar nga KEDNJ.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjes së arsyeshme dhe objektive.

⁴ Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991.

⁵ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁶ Ratifikuar me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002

⁷ Shih: Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, prg 30.

(vendimi nr. 19, datë 09.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (*Vendimet nr.18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2019 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se, trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁸. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm””⁹

LMD, është një ligj i cili është miratuar mbështetur dhe në zbatim të nenit 18 të Kushtetutës. Në linjë me interpretimin e Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së, sipas LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet: *““Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

LMD parashikon dhe jep përkufizimin e disa formave nëpërmjet të cilave shfaqet diskriminimi. Referuar nenit 3, pika 17, të LMD, përcaktohet se: *“17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.”*

⁸ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁹ Shih: *Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe*, datë 14.05.2016, § 89, *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, pala ankuese e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD, ku parashikohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”* I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës, parashikohet edhe në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se: *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.”*

Në lidhje me barrën e provës në çështjet e diskriminimit, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 16 datë 12.03.2024 (V-16/24), ndër të tjera thekson se: *“....aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë prima facie ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi.”*

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁰

¹⁰ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-laë-2018_en.pdf, fq.232.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë *trajtim të mundshëm diskriminues* dhe *ekzistencës së këtij trajtimi në realitet*. Barra e provës zhvendoset dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, *duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim*.

Sipas praktikës gjyqësore të vendosur nga GJEDNJ, prova, mund të rrjedhë nga bashkë ekzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme ose e supozimeve të ngjashme të faktit të pakundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes së nevojshme për të arritur një përfundim të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura thelbësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe të drejtën e pretenduar¹¹.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është në rastin konkret ankimi për diskriminim i paraqitur pranë Komisionerit dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër, në rastin konkret Bashkisë Patos.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se ankuesi Sh.B, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, në lidhje me largimin e tij nga puna si dhe mospërfitimin e dy pagave shpërblim pas përfundimit të funksionit, bazuar në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, të ndryshuar dhe mospagesën e shpërblimit për 10 (dhjetë) ditë leje vjetore të paguar pakryer dhe të mbartur nga viti 2023.

Në ankesën objekt shqyrtimi ankuesi pretendon se largimi i tij nga puna por edhe disponimet e punëdhënsit në lidhje me refuzimin për ti paguar ankuesit shpërblimet që i takonin si pasojë e përfundimit të marrëdhënies së punës, kanë ndodhur si pasojë e paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit.

Rezulton e provuar se:

¹¹ GJEDNJ, *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (GC) paragrafi 147, (ECtHR, *Nachova and others v. Bulgaria* [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, *D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, *D.H. and others v. the Czech Republic* [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

- Bashkia Patos ka marrë dijeni nëpërmjet shkresës nr. 1575/1 prot, datë 26.11.2024, të Komisionerit, se ankuesi ka parqitur ankesën nr. 241, datë 19.11.2024, në të cilën pretendon diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore/ statusit të tij si person në hetim.i pandehur nga organi i prokurorisë.
- Menjëherë pas marrjes dijeni për paraqitjen e ankesës pranë Komisionerit, Bashkia Patos, më datë 3.12.2024, ka ngritur një grup pune, bazuar në urdhrin nr. 298, datë 3.12.2024 *“Për ngritjen e grupit të punës për informacion”*, të Kryetarit të Bashkisë Patos, i kryesuar nga Kryetari i Bashkisë, kundrejt të cilit ankuesi kishte ngritur pretendimet për diskriminim. Bazuar në urdhrin e Kryetarit të Bashkisë, grupi i punës ngrihej për të verifikuar pretendimet e paraqitura nga ankuesi në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit.
- Referuar procesverbalit të mbajtur nga grupi i punës nr. 4250/3 prot, datë 10.12.2024, edhe pse qëllimi ishte mbledhja e informacionit për pretendimet e ankuesit në vendin e punës, të cilat konkretisht kishin të bënin ndër të tjera me cenimin e pagës, pengimin në ushtrimin e funksionit si Sekretar i Përgjithshëm, nga ana e Kryetarit të Bashkisë, ky i fundit në cilësinë e urdhëruesit për ngritjen e grupit të punës por edhe si kryetar i grupit të punës, por edhe i gjithë grupi i punës, në asnjë moment nuk kanë verifikuar pretendimet e ankuesit. Përkundrazi pyetjet drejtuar punonjësve ishin se si sillej ankuesi si Sekretar i Përgjithshëm në raport me ata.
- Procesverbali nr.4250/3 prot, datë 10.12.2024, i mbajtur nga grupi i punës, nuk iu vendos në dispozicion Komisionerit në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 241, datë 19.11.2024 por njëkohësisht as ankuesit. Ky procesverbal u depozitua nga Bashkia Patos gjatë shqyrtimit të ankesës objekt shqyrtimi.
- Procedura disiplinore ndaj ankuesit, ka filluar në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit për nëpunësin civil, pasi është Kryetari i Bashkisë ai i cili, ka urdhëruar fillimin e ecurisë disiplinore dhe jo Komisioni i Disiplinës.
- Procedura disiplinore është zhvilluar në kundërshtim me parimin e një procesi të rregullt ligjor dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni për nëpunësin civil.
- Deri në materializimin e vendimarrjes së Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore ndaj ankuesit, shkeljet e pretenduara ndaj këtij të fundit nuk janë pasqyruar në asnjë akt dhe t'i jenë komunikuar paraprakisht ankuesit, për tu njohur me to dhe për paraqitur parashtrime dhe prova në mbrojtje të tij.
- Asnjë nga shkeljet e pretenduara në ngarkim të ankuesit nuk rezultoi e provuar.
- Në kundërshtim me garancinë ligjore të parashikuar nga neni 15, pika 2, të LMD, punëdhënësi/Bashkia Patos, ka cenuar të drejtën e garantuar nga kjo dispozitë ligjore që i mundëson ankuesit të vijojë punën deri në përfundim të shqyrtimit të ankesës pranë Komisionerit. Përkundrazi, menjëherë me marrjen dijeni për shqyrtimin e ankesës nr.241, datë 19.11.2024, pranë Komisionerit, punëdhënësi ka filluar ecurinë disiplinore ndaj ankuesit më datë 12.12.2024 duke e finalizuar atë me marrjen e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”* më datë 18.12.2024
- Refuzimi i Bashkisë Patos për ti paguar ankuesit 2 pagat mujore si shpërblim pas largimit nga funksioni në zbatim të nenit 7, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 dhe shpërblimit për 10 ditë leje

të paguar të pakryer dhe të mbartur nga viti 2023, rezultoi haptazi në kundërshtim me kuadrin ligjor që rregullon këto dy të drejta.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe *krijojnë prezumimin se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit dhe se* trajtimi i disfavorshëm dhe pasojat negative, që i kanë ardhur ankuesit, konkretisht largimi nga puna dhe mospërfitimi i shpërblimeve, kanë ardhur si reagim ndaj ankesës për diskriminim të paraqitur para Komisionerit, ankesë e cila synonte zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit për shkak të gjendjes shoqërore/statusit si person në hetim/i pandehur nga organi i prokurorisë.

Në këto kushte, punëdhënësi/Bashkia Patos, ka barrën e provës që të provojë se ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në lidhje me trajtimin e padrejtë dhe të disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesit, në mënyrë që rrëzojë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për shkak të paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit.

Bashkia Patos, nuk arriti të provojë se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm të cilit i është nënshtruar ankuesi, nuk ka lidhje shkakësore me paraqitjen e ankesës për diskriminim paraqitur pranë Komisionerit, ndërsa justifikimet e paraqitura në lidhje me largimin nga puna të ankuesit dhe refuzimin për ti paguar atij shpërblimet që rrjedhin si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, rezultuan plotësisht të pabazuara. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e punëdhënësit/Bashkia Patos, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi, për të gjitha momentet e konstatuara në këtë vendim, mbetet ankesa për diskriminim e paraqitur para Komisionerit.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative për të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi.

Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi Sh.B është diskriminuar nga ana e punëdhënësit/Bashkia Patos, duke u viktimizuar, si pasojë e paraqitjes pranë Komisionerit të ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore/statusit si person në hetim/i pandehur nga organi i prokurorisë. Për rrjedhojë Bashkia Patos, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 3, pikat 1 e 17, nenit 5, pika 1 dhe nenit 12, pika 1, gërma "c", të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Bazuar në nenin 3/1 *“Format e rënda të diskriminimit”*, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet: *“Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.”*

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur sjellja diskriminuese ndaj ankuesit është kryer nga ana e punëdhënësit/Bashkia Patos më shumë se një herë, jemi në kushtet e një forme të rëndë të diskriminimit, sipas përcaktimit të nenit 3/1, i ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Ankuesi nuk ka paraqitur para Komisionerit asnjë kërkim, për marrjen e masave në lidhje me rregullimin e situatës diskriminuese të konstatuar. Në këto kushte Komisioneri, nuk do të disponojë në lidhje me marrjen e masave nga ana e Bashkisë Patos.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 e 33 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit dhe në formën e rëndë, të ankuesit Sh.B, si pasojë e paraqitjes pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të ankesës për shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me pretendimin e tij për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, nga ana e Bashkisë Patos.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shoqërore/statusi si i pandehur

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Viktimizim (për shkak të paraqitjes së ankesës për diskriminim pranë Komisionerit) dhe Formë e rëndë diskriminimi